



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 320 Prot.

Tiranë, më 17.05.2016

V E N D I M

Nr.58, datë 17.05.2016

“Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje administrimin e shërbimit civil në institucionin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë “Mbi verifikimin e ekzekutimit të vendimit nr. 44, datë 28.04.2015 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, të zhvilluar në institucionin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

Vërej se:

Në zbatim të Vendimit nr.3, datë 27.01.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në institucionin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 44, datë 28.04.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në të cilin është vendosur:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, të kryer në institucionin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.

2. Njësia përgjegjëse të revokojë aktin e konfirmimit për punonjësen ***** në pozicionin “*Specialiste*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe të vijojë procesin me nxjerrjen e vendimit të deklarimit të statusit të punësimit, si nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
3. Njësia përgjegjëse të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësen ***** në pozicionin e punës “*Inspektor*”, në Drejtorinë e Hetimit dhe Inspektimit, duke i shtuar faktin që punonjësja duhet të konsiderohet në periudhë prove, për periudhën e mbetur prej 4 muaj.

Njësia përgjegjëse të zbatojë të gjitha kërkesat që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë krijimin e kushteve për përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA) dhe përcaktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur për ecurinë e tij.

4. Njësia përgjegjëse të fillojë menjëherë procesin e hartimit të përskrimeve të reja të punës, në përputhje me kërkesat dhe standartet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.
5. Të përfundojë verifikimi i gjendjes gjyqësore për nëpunësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe të materializohet procesi në dosjen e personelit.
6. Të plotësohet dosja e personelit, në rastet e konstatuara me mungesa, sipas aneksraportit që është pjesë e këtij vendimi.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural, prej 30 ditësh, Komisioneri vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për të verifikuar ecurinë e zbatimit të vendimit, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” dhe në Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Kjo procedurë ka filluar me Vendimin nr.36, datë 01.04.2016, të Komisionerit, me anë të të cilit është ngritur grupi i punës, i cili është ngarkuar për t’u paraqitur në subjektin e mbikëqyrjes dhe për të verifikuar nivelin e zbatimit të vendimit paralajmërues.

Bazuar në vendimin e mësipërm të Komisionerit, grupi i punës kqyri dosjet e personelit, si dhe çdo akt tjetër administrativ, të nevojshëm për të verifikuar zbatimin e vendimit.

Në përfundim të verifikimit, rezultoi se :

- ✓ Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 2 të vendimit, njësia përgjegjëse në përputhje me nenin 128 të Kodit të Procedurave Administrative, “*Ndryshimi dhe*

zëvendësimi i akteve administrative”, ka zbatuar rekomandimin e Komisionerit duke nxjerrë aktin e deklarimit si nëpunëse civile nr. 596, datë 16.06.2015, për nëpunjësën *****, në pozicionin *”Specialiste”* në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun. Me nxjerrjen e këtij akti administrativ konsiderohet i zbatuar rekomandimi i pikës 2 të pjesës urdhëruese të Vendimit nr.44, date 28.04.2015.

- ✓ Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 3 të vendimit, njësia përgjegjëse në përputhje me nenin 128 të Kodit të Procedurave Administrative, *“Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative”* ka zbatuar rekomandimin e Komisionerit duke nxjerrë aktin e deklarimit si nëpunëse civile nr.477, datë 15.05.2015, për nëpunjësën *****, në pozicionin *“inspektore”* në Drejtorinë e Hetim-Inspektimit, pas plotësimit të periudhës së provës.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 4, rezultoi se përshkrimet e punës janë bërë sipas lidhjes 4, bashkëlidhur Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* dhe janë nënshkruar nga nëpunësi civil, eprori direkt, si dhe nga Sekretari i Përgjithshëm.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 5 dhe 6, rezultoi se ishte bërë verifikimi i gjendjes gjyqësore dhe ishte plotësuar dosja e personelit me aktet që mungonin (*dëshmi penaliteti dhe raporte mjekësore*). Ky dokumentacion ishte administruar në dosjen e personelit

Sa më sipër, konstatoj se Vendimi nr.44, datë 28.04.2015 , *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ”*, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.**

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 44, datë 28.04.2015 ,*“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA